



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Fier, më 02.02.2026

Njoftim Publik

Fokusi i njoftimit publik: Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore dhe vendore

Në zbatim të ligjit 86/2025 dt 11.12.2025 “ Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe e detyrimeve të pagueshme në doganë”, Bashkia Fier njofton subjektet debitore se:

1-Ligji 86/2025 parashikon masa për faljen, shuarjen ose pagesën e detyrimeve tatimore sipas kushteve, afateve dhe kategorive të përcaktuara shprehimisht në të.

2- Përfitimi nga ky ligj zbatohet vetëm për detyrimet që përfshihen në objektin e tij, në përputhje me përcaktimet ligjore dhe aktet përkatëse zbatuese.

3-Tarifat bashkiake, si pagesa për shërbime vendore, trajtohen sipas natyrës së tyre juridike dhe legjislacionit përkatës.

Për çdo rast konkret, subjektet apo individët që pretendojnë përfitim nga Ligji nr 86/2025, ftohen pranë zyrës me një ndalesë për verifikimin e detyrimeve dhe sqarimin e kushteve ligjore.

..